



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E AVOKATISË GJIROKASTËR
Av.KLODJAN MICKA. NIPT.L22621601A
Adresa:Lagjia "18 Shtatori" Gjirokastër,përballë Gjykatës së Shkallës së Parë.
Mob.0693525628 Tel.084268184

AKT - THEMELIMI

I

SHOQERISE "NARDI PETROL" sh.a.

Sot, me date 27.07.2012 (Njezete e shtate Korrik dymije e dymbedhjete), perpara meje, avokat Klodjan Micka, Avokat prane Dhomes se Avokatisë Gjrokaster, u paraqit personalisht:

Z. Leonard Micka, i biri i Eqeremit,i dt l 10.02.1976, lindur në Nivice Tepelene dhe banues në Tiranë, rruga "Muharrem Butka" Nd 19,H.2. ,Ap 22. , Njësia Bashkiake Nr.5 Tiranë, me shtetesi e Kombesi shqiptare, madhor me zotësi juridike për të vepruar, pajisur me Letërnjoftimin (ID) Nr.027786435 , me vullnet të lirë të plotë e të sinqertë, I cili kerkoi perpilimin e ketij **Akti Themelimi** te shoqerise tregetare "**NARDI PETROL " sh.a.**, me termat e meposhteme :

NENI 1

Te themeloje shoqerine Tregetare "NARDI PETROL" sh.a. ne formen e nje shoqerie Anonime. Ne te gjitha Aktet qe do te nxjerr shoqeria kundrejtuar "NARDI PETROL" sh.a., sipas percaktimeve te bera ne kete Akt Themelimi dhe Statut te Shoqerise.

NENI 2

Qellimi i krijimit te Shoqerise.

Qellimi I krijimit te kesaj shoqerie eshte zhvillimi aktivitetit ekonomik te fusha te ndryshme. Veprimtaria e kesaj shoqerie do te jete thellesisht me karakter ekonomik dhe qellim fitimprures.

NENI 3

Emri dhe vula e shoqerise

Shoqeria, do te dale ne qarkullimin juridiko – civil me emrin "NARDI PETROL" sh.a. Ajo do te kete vulen e saj.

NENI 4

Objekti i Veprimtarisë

- Import-eksport, transport, tregëtim me shumicë i naftës bruto, gazit natyror, gazit të lëngshëm, i nënprodukteve të përpunuara të naftës si benzinë, benzinë avionash, gasoil, vajguri ndriçues, vajguri avionash, aromatikë, solvent, ëhite spirit, lëndë djegëse solar, mazut, biruto, squfur, vajra lubrifikantësh etj.
- Shoqëria mund të krijoj studime dhe asistencë teknike, kërkimore dhe shkencore në fushën e nxjerrjes dhe përpunimit të naftës dhe gazit, analizat laboratorike të të gjithë nënprodukteve të naftës.
- Investime në fushën e turizmit. Agjensi turistike. Tour operator.
- Import-eksport, tregëtim me shumicë të lëndëve të para, makineri, produkte të fushës së industrisë mekanike, elektrike, ndërtimi, kimike ushqimore etj.
- Investitor privat në fushën e ndërtimeve publike, shtetërore, civile etj.

NENI 5

Selia e Shoqërisë dhe Afati

Shoqëria e ka selinë në qytetin e Memaliait, Rruga Nacionale, ish fabrika e fosforit. Shoqëria mund të hapë edhe zyra përfaqësie dege, të krijoj filial dhe /ose të realizoj çdo lloj pjesmarrje të parashikuar nga ligji në shoqëri të tjera, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë. Shoqëria do të zhvilloj aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar.

NENI 6

Kapitali

Kapitali Themeltar i Shoqërisë është 3.500.000 lekë dhe është i ndarë në 3.500 aksione me vlerë nominale 1.000(nje mije) lekë shqiptare secili. Kapitali i shoqërisë nënshkruhet dhe derdhet tërësisht në të holla nga aksioneri i shoqërisë përkatësisht:

- Aksioneri, Leonard Micka, 3.500 aksione me vlerë të përgjithshme 3.500.000 lekë që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.
- Aksionet janë tërësisht nominale dhe janë të transferueshme sipas ligjit shqiptar në fuqi.
- Aksioneri përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve vetëm me vlerën e pashlyer të aksioneve të nënshkruara.
- Çdo aksion i jep të drejtën e një vote titullarit të tij.
- Kapitali i shoqërisë mund të rritet nëpërmjet kontributit në natyrë apo të holla siç parashikohet në ligj.

NENI 7

Aksioneri i vetëm i shoqërisë "NARDI PETROL" sh.a. zoteron në këte shoqëri si më poshtë : z.Leonard Micka zotëron 100 % të vlerës së kuotave në kapitalin fillestar të shoqërisë të barabartë me 3.500 aksione me vlerë nominale 1.000 leke.

NENI 8

Organet e shoqërisë

-Aksioneri i vetëm

-Këshilli i administrimit, si organ i vetëm administrimi, i cili ushtron, njëkohsisht funksione administrimi e mbikëqyrje, të veprimtarisë së shoqërisë(sistemi me një nivel)

Neni 9

Çështjet e lidhura me veprimtarinë dhe funksionimin e shoqërisë, ushtrohen nëpërmjet Mbledhjes së Aksionerit të vetëm. Aksioneri i vetëm, merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

a)Përcaktimin e politikave tregtare

b)Ndryshimin e statusit.

c)Emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillit të administrimit

ç)emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar.

d)Miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" e "ç" të këtij neni.

dh) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.

e) Shpërndarjen e fitimeve vjetore

ë) Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar

f) Pjestimin e aksioneve dhe anulimin e tyre

g) Ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta.

gj) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit.

h) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë

i) Miratimin e rregullave procedural të mbledhjes së saj

j) Çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji

Aksioneri i vetëm, merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e këshillit të administrimit dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar. Të gjitha vendimet e marra nga aksioneri i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Vendimet e paregjistruara në regjistrimin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejtat në mirëbesim, përveç

rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.



Neni 10

Këshilli i Administrimit

Funksioni, kompetencat dhe shpërblimi

Këshilli i administrimit ka këto këto të drejta dhe përgjegjësi:

- a) Të japë direktivat për administratorët për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë
- b) Të kontrollojë e të mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët.
- c) Të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatoj vendimet e asamblesë.
- ç) Të thërras mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interes të shoqërisë.
- d) Të kujdeset që shoqëria të respektoj ligjin dhe standartet e kontabilitetit.
- e) Të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statusit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e këshillit të administrimit për t'u paraqitur asamblesë së përgjithshme, sëbashku me një raport të këshillit të administrimit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar.
- ë) Të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur e raporti i auditimit, drejtuar asamblesë së përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të këshillit të administratorëve. Raporti i këshillit të administrimit, përmendur në shkronjën "e" të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit.
- f) Të emëroj dhe të shkarkoj administratorët, të ndaj kompetencat ndërmjet tyre.
- g) Të përcaktoj shpërblimin e administratorëve.
- gj) Të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit.
- h) Të vendos krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave, për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja.
- i) Të kryej veprimet e tjera, të përcaktuara në ligj.

Neni 11

Numri i anëtarëve

Këshilli i administrimit do të përbëhet nga 3 anëtarë. Anëtarët janë individë.

Anëtarët e parë të këshillit të administrimit të emëruar në këtë detyrë për një periudhë 3 vjeçare janë:

- | | | |
|------------|-------|---------------------------------------|
| 1. Valbona | Micka | Kryetare e Këshillit të Administrimit |
| 2. Klodjan | Micka | Anëtarë i Këshillit të Administrimit |
| 3. Afrim | Gjyli | Anëtarë i Këshillit të Administrimit |

Administrator i shoqërisë i emëruar në këtë detyrë për një periudhë 3-vjeçare me të drejtë rizgjedhje është Leonard Micka.

Neni 13

Marrja e vendimeve

Vendimet e këshillit të administrimit vlerësohen të vlefshme, nëse në procesin e vendimmarrjeve janë të pranishëm më shumë se një e dyta e anëtarëve. Kur për një çështje ka barazim votash, vota e kryetarit mbizotëron. Vendimet e këshillit të administrimit mund të merren sipas përcaktimeve në këtë statut apo të rregulloreve të këshillit, duke shprehur votën me shkresë, me telefon apo me mjete të tjera komunikimi elektronik, me përjashtim të rasteve kur një anëtar i këshillit ka kundërshtime për këtë mënyrë vendimmarrjeje.

Neni 15

Administratori

Funksionet dhe kompetencat

Administratori, administron dhe drejton pasuritë dhe aktivitetin e shoqërisë dhe përfaqëson ligjërisht shoqërinë.

Administrator i shoqërisë është z. Leonard Micka i cili do të ushtroj kompetencat sipas ligjit dhe këtij statusi për një periudhë 3-vjeçare me të drejtë rizgjedhje.

Emërimi dhe Kohëzgjatja e Mandatit

Administratori emërohet dhe shkarkohet nga këshilli i administrimit.

Administratori i shoqërisë mund të rizgjidhet. Anëtarët e këshillit të administrimit mund ta kryejnë detyrën e administratorit për sa kohë shumica e anëtarëve të këshillit të administrimit janë anëtarë të pavarur, që nuk kryejnë këtë detyrë. Emërimi prodhon pasoja pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe të drejtat e të tretëve mbrohen sipas nenit 12 të këtij ligji. Statuti mund të vendos rregulla të posaçme për emërimin.

2. Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të zgjidhet si administrator i një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas. Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të jetë kryetar i këshillit të administrimit të një shoqërie të kontrolluar dhe administrator i një shoqërie të kontrolluar nuk mund të jetë kryetar i

këshillit të administrimit të shoqërisë mëmë. Çdo emëtim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është absolutisht i pavlefshëm. Të drejtat e të tretëve mbrohen sipas nenit 12 të këtij ligji.

3. Administratori ka të drejtë dhe detyrohet:

- a) të kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë
- b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare
- c) të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregulltë të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë.
- ç) të përgatisin dhe të nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqesin këshillit të administrimit për miratim, sëbashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për tu paraqitur më pas për miratim nga asambleja e përgjithshme.
- d) të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë.
- dh) të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashkrimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera.
- e) të raportoj përpara këshillit të administrimit për zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë.
- ë) të kryejnë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

4. Detyrat, që i cakton ligji këshillit të administrimit, nuk mund t'u delegohen administratorëve.

5. Në rastet e parashikuara në pikat 3,4,5 të nenit 136 të ligjit 9901 datrë 14.04.2008, administrator duhet të informoj menjëherë kryetarin e këshillit të administrimit.

NENI 16

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degeve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit të shoqërisë.

NENI 17

Ortaku dhe anëtarët e organeve drejtuese të shoqërisë janë të detyruar të ruajnë sekretin e themelimit të shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhvendojnë shoqërinë për demet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 18

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statusi si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të zgjidhet në Gjykatën kompetente.



Aksioneri : Leonard Micka